



Për: z. Besnik Bislimi, Ministër i Financave dhe Transfereve
z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës

Nga: Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF

Lënda: Kërkesë

Datë: 6 Prill 2020

Të nderuar,

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve i cili përfaqëson 31 organizata jo qeveritare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve vlerëson iniciativën e qeverisë për miratimin e Pakos Emergjente Fiskale në vlerë prej 179.6 milionë euro, duke e konsideruar atë si një hap shumë të qëlluar i cili pritet të zbusë dëmet ekonomike të ardhura si pasojë e pandemisë COVID-19.

Në anën tjetër, KOMF shpreh shqetësimin e thellë për faktin që 1) Skema për Përkrahjen Materiale të Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Përhershme të Kufizuara, 2) Strehimi Familjar për Fëmijët pa Përkujdes Prindëror dhe 3) Staf i profesional i strehimoreve që punojnë 24 orë shërbim, nuk janë përfshirë si përfitues në kuadër të Pakos Emergjente Fiskale.

1. Skema për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme mbështet familjet që kanë fëmijë me aftësi të përhershme të kufizuara në vlerën mujore prej 100 Euro. Numri i fëmijëve që përfitojnë nga kjo skemë aktualisht në Kosovë është 2360 fëmijë. Shuma prej 100 Euro është e pamjaftueshme për mbulimin e nevojave themelore (produkte ushqimore, produkte higjienike, trajtim terapeutik, pajisje të nevojshme, materiale didaktike-mësimore, medikamente, etj.) për fëmijët me aftësi të kufizuara.
2. Strehimi Familjar për fëmijët pa kujdes prindëror ndahet në dy lloje: strehimi tek të afërmit dhe strehimi në familje strehuese alternative. Familjet strehuese që ofrojnë strehim për fëmijët pa kujdes prindëror që janë farefis me fëmijën (strehimi tek të afërmit), marrin 75 Euro në muaj për shpenzimet mujore të fëmijës. Ndërsa familjet që strehojnë fëmijë pa kujdes prindëror e që nuk janë farefis i fëmijës (familjet strehuese alternative), marrin 250 Euro në muaj për shpenzimet mujore të fëmijës. Aktualisht, numri i fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar tek të afërmit është 497 fëmijë, përderisa numri i fëmijëve në strehim familjar alternativ është 54 fëmijë. Familjet strehuese alternative janë familje vullnetare të rekrutuara nga Qendrat për Punë Sociale për të ofruar strehim për fëmijët pa kujdes prindëror, ato nuk realizojnë asnjë përfitim social në emër të të qenit familje strehuese dhe në këtë mënyrë rrezikohet qëndrueshmëria e tyre.

Për arsytet e cekura më sipër si dhe për faktin që shpenzimet e familjeve janë rritur si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, kërkojmë që dy skemat e mësipërme të përfshihen në kuadër të pakos emergjente, duke paraparë një shtesë të caktuar në vlerë monetare për muajt në vijim.

3. Strehimoret apo qendrat rezidenciale që ofrojnë shërbime 24 orë për fëmijët pa përkujdesje prindërore, viktime të dhunës në familje, viktime të abuzimit dhe trafikimit gjatë gjithë kësaj periudhe kanë vazhduar të ofrojnë shërbime me kapacitet të plotë. Sikurse shumë pozita që janë vlerësuar dhe konsideruar me rrezik në këtë periudhë edhe këto pozita ofrojnë shërbime 24 orë, janë të hapura për rastet e reja në nevojë për akomodim, janë të ekspozuara drejtpërdrejt ndaj rrezikut të infektimit në vendin e tyre të punës. Kërkojmë që stafi profesional i strehimoreve që ofron shërbime direkte 24 orë (jo menaxhmenti dhe stafi administrativ) të jenë po ashtu përfitues në kuadër të pakos emergjente - Masa 6, Sigurimi i shtesës mbi pagë për muajin Prill dhe Maj.

Duke konsideruar interesin e përbashkët që të gjithë qytetarët të gëzojnë mirëqenie sociale, KOMF kërkon vëmendjen tuaj të shtuar, në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve pa përkujdes prindëror gjatë kohës së pandemisë COVID-19.

Sinqerisht,
Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF

KOMF, i themeluar në 2011, është koalicioni i përbërë nga 31 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Organizatat anëtare të KOMF: Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim –ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti, Nevo Koncepti, Qendra Labyrinth dhe Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmohatarë (PEN).